REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Datë:	05.07.2020
Referencë:	
Për:	z.Imri Ahmeti Kryetar i Komunës së Lipjanit
CC:	Z Fauz Xhemajli – Nënkryetar i Komunës së Lipjanit Z, Lulzim Qerimi –Nënkryetar i Komunë së Lipjanit
Nga:	Elmaze Behluli – Drejtoreshë e DKA-së
Lënda:	Raport i punës për muajin Qershor , datë 01.06.2020 deri me 30.06.2020

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me 23.06.2020 ka përfunduar viti shkollor 2019-2020, vit i cili për dallim nga vitet tjera ka qenë një sfidë dhe përvojë e re si për personelin arsimor ashtu edhe për nxënësit për arsye të paraqitjes së pandemisë COVID 19. Drejtoria e Arsimit, në vazhdën e punëve dhe detyrave, të paraparë, në funksion të ngritjes së cilësisë dhe zhvillimeve dhe përmirësimeve të kushteve në të gjitha segmentet e proceseve arsimore, gjatë muajit qershor të vitit 2020, ne bashkëpunim me MASH dhe drejtorët e shkollave ka arritur të realizojë punë dhe detyra të shumta, të parapara sipas planit të veprimit dhe punëve dhe detyrave tjera të paraqitura.. Duhet theksuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe sfida dhe peripeci të ndryshme, të cilat kanë reflektuar në disa punë dhe detyra që të realizohen me kohë të përcaktuar, por me një përkushtim dhe janë tejkaluar dhe janë duke u realizuar të gjitha planifikimet e parapara Në të tri nivelet e shkollimit është mbajtur mësimi në distancë duke iu përmbajte vendimit të MASHT-it për institucionet e arsimit parauniversitar në Republikën e Kosovës, gjithashtu është mbajte edhe komunikimi me MASHT-in , me drejtor e mësimdhënës. ndërsa punëtorët e drejtoratit kanë vazhduar punën në bazë të rekomandimeve të IKSHP dhe vendimeve të kryetarit të komunës në përputhje me situatën e krijuar.

AKTIVITETET-

- Dërgimi i raportit në MASHT, lidhur me mbarëvajtjen e mësimit online-distancë për shkollat fillore dhe të mesme në Komunën e Lipjanit, (numri i nxënësve të përfshirë në mësim, numri i orëve të mbajtura, numri i mësimdhënësve të angazhuar, lëndët mësimorë të mbajtura).
- Mbajtja e takimit me disa drejtor rreth përgaditjeve për mbajtjen e mësimit plotësues për nxënësit e klasave të IX që fillon me 08.06.2020.
- Kompletimi i të dhënave në pytsorin për përformancë dhe dërgimi te zyrtari përgjegjës.
- Përgatitjet për mbajtjen e testit të arritshmëris dhe testit të maturës-formimi i qendrave të testimit me paralele dhe me numër të nxënësve sipas udhëzimeve të MASHT –it mbi distancën sociale .
- Shpallja e njoftimit për regjistrimin e fëmijëve në QEAP "Çerdhja" në Lipjan

- Pranim i kërkesave nga arkiva dhe shqyrtimi i tyre(pushime të lehonisë , kërkesa për paga jubilare etj).
- Lëshimi i vërtetimeve për vitet e 90-ta për mësimdhënës të pensionuar.
- Me 23.06.2020 dalje ë teren – verifikimi i përvojës së punës sipas kërkesës së pales
- Shpallja e konkursit për drejtor për 4 shkollave.
- Takim me palë

- Nënshkrimi i marrëveshjes me Word Vizion për krijimin e kabineteve të TI dhe furnizimi I SHFMU "Ismail Luma" me instrumente muzikore/, nga kjo marrëveshje kanë përfituar 11 shkolla

Edhe pse DKA me kohë ka bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e testit të arritshmëris dhe testit të maturës për shkak të pandemisë janë shtyer për datën 20.07.2020 testi i arritshmëris dhe datën 29.07.2020 testi i maturës

Çështjet financiare dhe buxhetore (statistikat)

Kërkesat në prokurim për:

- Kryerjen e shërbime të transportit për të gjithë nxënësit e klasave të IX nga të gjitha shkollat dhe administruesve me rastin e mbajtjes së testit të arritshmërisë
- Kërkesën për furnizim me ujë të pijes për nxënës që i nënshtrohen testit të arritshmërisë
- Kërkesë prokurimit për furnizimin e të gjithë nxënësve me maska dorëza dhe dezinfektues për mbajtjen e testit të arritshmërisë dhe testit të maturës shtetërore
- Pas pranimit të këtij materiali i tëri është shpërndarë në të gjitha shkollat
- Kërkesë prokurimit për furnizim me inventar për 3 shkolla :
- SHFMU " Haradin Bajrami" Magurë
- SHFMU " Drita " Rubovc dhe
- QEAP "Çerdhja Lipjan

ZOTIMET:

- Shpenzimet për transport dhe ujë për nxënës për mbajtjen e testit të arritshmërisë
- Zotimet për komunali
- Zotimet për furnizim të shkollave me lëndë djegëse për vitin shkollor 2020-2021

- 1. Përgatitja dhe dërgimi i formularëve për ndryshime në listën e pagave në ministri - Peyroll për muajin Qershor dhe atë:
- a) Formular për punëtor te rinj,
- b) Formular për largime (pensionime, skadim kontrate),
- c) Formular për ndryshime (pushime te lehonisë, ndërrim norme, shtim te fakultetit),
- d) Formular për retroaktive (pagesat e pagave përcjellëse)
- e) Transfer bankar (ndërrim te xhirollogarive)